

VENDIM
Nr.325, datë 24.7.1992

PËR NJË KONTROLL DHE ADMINISTRIM MË TË MIRË TË SHPËRNDARJES E TË
TREGTIMIT TË ARTIKUJVE TË SHPORTËS

Me propozimin e Minsitisë së Tregtisë e të Bashkëpunimit Ekonomik me Jashtë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Ministria e Tregtisë dhe e Bashkëpunimit Ekonomik me Jashtë, sipas normave mesatare për frymë, cakton kontigjentin e artikujve të shportës për çdo rreth dhe organizon shpërndarjen e tyre nëpërmjet ndërmarrjeve të tregtisë me shumicë.

2. Komitetet ekzekutive të rretheve, mbi bazën e kontingjenteve të artikujve të shportës që u jepen, i shpërndajnë ato në ndërmarrjet tregtare sipas normave për frymë të miratuara për fshatin dhe për qytetin. Ndërkohë përcaktojnë e shpërndajnë dokumentacionin e nevojshëm, me të cilin pajisen konsumatorët për t'u furnizuar me këta artikuj.

3. Ndërmarrjet tregtare që shpërndajnë artikujt e shportës, caktojnë sasisë përkatëse për çdo njësi të miratuar nga komiteti ekzekutiv, sipas numrit të frymëve dhe normave të miratuara, organizojnë shpërndarjen dhe kontrollojnë shitjen mbi bazën e dokumenteve të lëshuara nga Komiteti Ekzekutiv i Rrethit.

4. Ndalohet shitja nga personat fizikë e juridikë privatë e artikujve ushqimorë të shportës të importuara dhe prodhuara nga ndërmarrje shtetërore, me përjashtim të personave fizikë e juridikë të caktuara nga komitetet ekzekutive të rretheve.

5. Lejohet shitja e lirë nga personat fizikë e juridikë privatë e artikujve ushqimorë të shportës të importuara ose prodhuara nga vetë ata në qoftë se kanë dokumentet që vërtetojnë origjinën e mallit dhe kur çmimi i shitjes së tyre është brenda tavanit të veçantë që do të caktohet për subjektet private.

6. Detyrat e përcaktuara në këtë vendim të jenë objekt i detyruar kontrolli nga policia financiare dhe organet e kontrollit të ministrisë përkatëse dhe të komiteteve ekzekutive të rretheve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi